

Rifitimi i shtetësisë

Përshkrimi

Rifitimi i shtetësisë nga personi që ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare për shkak të premtimit për fitimin e një shtetësie tjetër.

Dokumentacioni i nevojshëm

- 1) Kërkesa e të interesuarit drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë.
- 2) Certifikata e lindjes;
- 3) Certifikata familjare;
- 4) Relacioni shpjegues dhe konfirmimi nga komisarati i policisë vendore dhe prefektura përkatëse lidhur me shtetësinë që kanë ose kanë pasur prindërit e çdo aplikuesi;
- 5) Deklarata noteriale e çdo aplikuesi madhor, ku deklarohet se nuk ka fituar shtetësi tjetër dhe se aktualisht është person pa shtetësi;
- 6) Vërtetimi i njësisë administrative përkatëse për çdo aplikues madhor;
- 7) Certifikata e lindjes ose e vdekjes së prindërve të çdo aplikuesi;
- 8) Fotografia e aplikuesit;
- 9) Mandat pagesa.

Hapat e procedurës

- 1) Paraqitja e dokumentacionit me postë ose personalisht;
- 2) Verifikimi i dokumentacionit nga konsulli;
- 3) Përcjellja e dokumentacionit zyrtarisht nga përfaqësia për autoritetet përgjegjëse;

Tarifa e shërbimit dhe afati

30 euro

3 muaj

Zyra

Të gjitha përfaqësitë diplomatike dhe konsullore

Shënime

Shtetësia shqiptare rifitohet në qoftë se personi nuk ka fituar shtetësinë e premtuar. Të gjitha dokumentet e lëshuara në Republikën e Shqipërisë pranohen kur janë nënshkruar nga titullari i institucionit. Aplikimet për shtetësinë shqiptare janë individuale, veç atyre të shtetasve të mitur, për të cilët shprehen prindërit e tyre. Dokumentacioni duhet të jetë i dy muajve të fundit.

Të gjitha dokumentet (të prodhuara në Shqipëri apo në vende të tjera) pranohen kur janë në harmoni të plotë me njëri tjetrin, pa gabime e korrigjime. Të gjitha dokumentet për shtetësinë sigurohen nga vetë të interesuarit.

Pagesa e tarifës së shërbimit konsullor kryhet nëpërmjet bankës.